

Tiranë, më 29.08.2022

P E T I C I O N

Drejtuar: Z. Edi RAMA, *Kryeministër i Shqipërisë*

Zj. Evis Kushi, **Ministre e Arsimit dhe Sportit**

Rektorëve të Universiteteve Publike

I nderuar z. Kryeministër!

E nderuar Zj. Ministre!

Të nderuar Rektorë!

Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH), mbështetur në nevojat/kërkesat akademike/ekonomike të punonjësve të IAL-ve publike, u është drejtuar në vijimësi institucioneve përgjegjëse, duke i parashtruar ato në formën e kërkesave të argumentuara.

- SPUSH i është drejtuar insitucionit tuaj me shkresat Nr. 286/1 Prot dhe Nr. 286/2 Prot., datë 17.05.2019, me lëndë: "Dërgohen kërkesat e SPUSH".
- SPUSH gjatë diskutimit të buxhetit të shtetit të vitit 2021 dhe 2022 ka paraqitur përpara Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Parlamentit, më datat 9.11.2020 dhe 7.11.2021, të njejtat kërkesa, depozituar dhe në trajtë shkresore me lëndë: "Propozime të SPUSH për reflektime të mundshme në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit 2022".
- SPUSH ka parashtruar kërkesat përkatëse të kësaj sindikate dhe në takimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), në datën 16 shkurt 2022.

Pavarësisht përpjekjeve tona deri më tani, fatkeqësisht nuk është parë ndonjë reflektim nga ana e institucioneve të niveleve të ndryshme, në lidhje me kërkesat e një shtrese, që në fakt duhet të ishte konsideruar e privilegjuar.

Në gjendjen aktuale ekonomike, e cila e ka vështirësuar edhe më shumë mbijetesën njerëzore (e natyrisht edhe atë akademike), SPUSH-ja vijon të parashtrojë kërkesat përkatëse në trajtën e një peticioni, i cili ka gjetur mbështetje me anë nënshkrimesh nga stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në të gjithë universitetet publike të vendit.

Kërkesat tona konistojnë në sa vijon:

1. Rritjen e pagave për pedagogët dhe stafin ndihmës akademik e administrativ.

SPUSH evidenton që rritja e inflacionit, çmimeve të ushqimeve dhe produkteve të tjera bazë të jetesës, nuk i përgjigjet pagesave të pedagogëve, të cilat janë më të ultat në rajon.

Propozohet të arrihet niveli i pagave të universiteteve publike të Kosovës brenda 2 viteve, me rritje 30 % në tetor 2022 dhe 20 % në tetor 2023.

2. **Rritjen e financimit për kërkimin shkencor** që të jetë të paktën 0.3 % e GDP, më 2023. Aktualisht është, në përqindje GDP^{je}, mbi 10 herë më i ulët se disa vende të Rajonit.
3. **Rivendosjen e shtesave mbi pagë**, për “Dëmshmëri shëndeti në punë”, për laborantët dhe stafin akademik që punojnë në laboratore, në kontakte me “substancë të rrezikshme dhe preparate të tjerë”.
4. **Rritjen e shtesës mbi pagën për vjetërsinë në punë**, për personelin akademik të punësuar me kohë të plotë në IAL-të publike, për çdo vit pune, nga masa 0.5% që është aktualisht, në masën 1% dhe nga 15 vjet që është aktualisht në 25 vjet.
5. **Rritjen e pagesës së orëve të ngarkesës suplementare** për pedagogët e brendshëm (PAE) dhe pedagogët e jashtëm me kontratë (PAK), në mënyrë që kjo që t’i afrohet vlerës së pagesës nga universitetet private.
6. **Rivlerësimin e orës mësimore, pasi ka një zbritje prej 50% të pagesës së orës mësimore** si rezultat i mosdiferencimit të orës mësimore të leksionit, e cila më parë kishte koeficientin 2 për leksionin në master dhe 1.5 për atë në bachelor, ndërsa tani e ka koeficientin 1, duke u bërë njëjloj me orët e tjera në auditor (seminare, laboratore, praktika, etj.)
7. **Rishikimin e tatimit prej 23% mbi pagesën ngarkesës suplementare si më poshtë:**
Pagesa e orëve suplementare të realizuara gjatë një viti akademik jepet njëherësh në fund të vitit dhe duke e bashkuar me pagën mujore, kur lëvrohet kjo shumë, kalon kufirin përkatës të tatimit 23%. Pagesa e orëve suplementare është shumatore e pagesave mujore që duhet të merreshin të shpërndara gjatë vitit akademik dhe për rrjedhojë tatimi duhet të llogaritej proporcionalisht për çdo muaj të vitit, pra maksimumi me 13%. Me këtë procedurë që është zbatuar gjatë këtyre viteve janë cënuar padrejtësisht interesat financiare të stafit akademik. **Kërkojmë të rishikohet mënyra e përllogaritjes së tatimit mbi këto të ardhura.**
8. **Amendimin e pikës c) të paragrafit të 3, i Kreut III të VKM Nr. 112, datë 23.2.2018**, i cili bën fjalë për kriteret për marrjen e titullit “Profesor” si në vijim: “... 3.c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar”.
Ndarja, disa me 2 (dy), disa me 1 (një) doktoraturë të mbaruar, bie ndesh me parimin kushtetues të barazisë juridike, pasi bëhet fjalë për të njëjtin titull akademik.
Propozojmë që zbatimi i kësaj pike të pezullohet deri më 2026, meqë doktoraturat e reja u rihapen më 2022, ndërsa për periudhën 2013 -2022 kanë qenë të mbyllura, duke e bërë të pamundur realizimin e këtij kushti.

-
9. Për të bërë transparencë mbi buxhetin dhe të ardhurat e universiteteve publike si dhe përdorimin e tyre, kërkojmë nga MAS-i që të ushtrojë kompetencat e saj ligjore, duke bërë menjëherë publike online, në platformën U-Transparenca dhe në website-t e çdo universiteti publik, të dhënat e hollësishme financiare, 3-mujore dhe vjetore, mbi përdorimin e këtyre fondeve nga IAL-të, për tre vitet e fundit, për të gjithë zërat e shpenzimeve (atyre korente, investimeve, pagave dhe shpërblimeve si për stafet akademike, ashtu dhe për autoritetet apo organet/bordet drejtuese, administratën mbështetëse të IAL-ve, fonde për bursa për studentë, si dhe shpenzime për kërkim shkencor dhe botime).

SPUSH është e bindur se çështjet e mësipërme janë vetëm një pjesë e problematikës asaj me të cilën çka realisht përballen universitetet publike shqiptare sot, **por mendojmë se adresimi dhe zgjidhja e tyre nga autoritetet qeveritare e universitare përgjegjëse është një fillim i domosdoshëm për përmirësimin kushtet aktuale dhe klimës në universitetet tona.**

Në pritje të reflektimit të institucioneve përkatëse për adresimin e zgjidhjeve të kërkesave mësipërme, SPUSH-ja shprehet e gatshme të japë ndihmesën e vet me ekspertizën e anëtarësisë së saj. Në respektim të akteve ligjore në fuqi anëtarët dhe mbështetësit e kësaj sindikate **gëzojnë mbrojtjen e të drejtave themelore demokratike** të punëmarrësve, përfshirë ndërprerjen e përshkallëzuar të mësimin, në rast mos reagimit nga ana e autoriteteve.

PËR SINDIKATËN E PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE TË SHQIPËRISË

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda OLLDASHI

KRYETARI

Prof. Asoc. Dr. Sandër KOVAÇI

Sindikata e Punonjësve të Universitetit të Tiranës, Kryetari, Msc. Qazim LATAJ

**Sindikata e Punonjësve të Universitetit Politeknik Tiranë,
Kryetari, Prof.Asoc.Dr. Klodian DHOSKA**

**Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, Universiteti i Mjeksisë së Tiranës,
Kryetari, Prof. Asoc.Dr. Gentian Stroni**

Sindikata e Punonjësve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, Kryetari, Prof. Dr. Lush SUSAJ

Sindikata e Punonjësve të Universitetit të Durrësit, Kryetare, Prof.Asoc.Dr. Erjola KEÇI

Sindikata e Punonjësve të Universitetit të Shkodrës, Kryetari, Dr. Peter SARAÇI

Sindikata e Punonjësve të Universitetit të Elbasanit, Kryetari, Prof. Asoc.Dr. Altin IDRIZI

Sindikata e Punonjësve të Universitetit të Korçës, Kryetare, Dr. Alba KREKA

Sindikata e Universitetit të Vlorës, Kryetari, Dr. Arben BAUSHI